



Planuar / Propozuar Planned / Proposed Revizuar / Revisited	23.03	2022	2	viti god year
Organ / Institucioni Org. / Inst.	SKPT/SHCK	1522/22	Shënim / Futerg Appendix	Sasia Kolicime Quantity
				1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.189/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1993/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.532/2021 të datës 14.06.2021 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted]

[redacted] kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "Transfer" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.03.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.532/2021 e datës 14.06.2021 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

### A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Shërbimi Korrektues të Kosovës, me datë 14.06.2021 ka ushtruar ankesë me numër protokollit 3037/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar që në mënyrë të detyrueshme është transferuar me datë 26.12.2019 në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, dhe se i njëjti kërkon që të rikthehet në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.06.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 23.06.2021 ka pranua nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 3280/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes shkresës me numër protokollit 3949/2020 të datës 28.07.2021, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës

numër A.nr.532/2021 e datës 14.06.2021, duke e udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë në gjykatën kompetent në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Ankuesi me datë 31.08.2021 ka ushtruar ankesë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Ndërsa kjo e fundit, më datë 25.02.2021 ka nxjerrë Aktgjykim A.nr.1993/21, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 28.07.2021, dhe ka detyruar të njëjtin që brenda tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 14.06.2021.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 3037/2021 të datës 14.06.2021 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 18.11.2019 me numër 3/72; Kërkesën për lejin e punimit të temës së diplomës; Fletëparaqitjen e temës së diplomës e datës 17.11.2019; Kërkesën e datës 16.11.2020; kërkesën e datës 28.01.2020; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018 i datës 11.12.2018; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 12.11.2019; Medaljen për besnikëri të vitit 2020; Diplomën e datës 08.12.2020 me numër 59; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.06.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 23.06.2021; Vendimin me numër 4388 e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës e datës 24.12.2019; Përgjigjen në kërkesë të datës 23.11.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Ndryshimin dhe Plotësimin e Kontratës së Punës të datës 21.08.2018; Kontratën e Punës së ankuesit të datës 30.06.2018; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Zyrtar Korrektues" në Shërbimin Korrektues të Kosovës; E-mailin e datës 23.06.2021 dërguar nga [redacted] për KPMSCHK; Shkresën e datës 22.06.2021 e protokolluar me numër 3299/2021 e pranuar në KPMSHCK me datë 24.06.2021; Njoftimin e datës 28.07.2021 më numër protokollit 3949/2021; Aktgjykimin A.nr.1993/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, E-mailin e datës 21.03.2022 dërguar nga Udhëheqësi i Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.532/2021 e datës 14.06.2021, e parashtruar nga ankuesi [redacted] është e *jashtafatshme*, sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës respektivisht sipas Kontratës së Punës të datës 30.06.2018, rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën *Zyrtar Korrektues* në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Me Vendimin numër 4388 të datës 23.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ankuesi është transferuar nga Qendra e Paraburgimit në Lipjan në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë. Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji nuk ka gjetur dëshmi së ankuesi e ka kundërshtuar me mjete juridike vendimin për transferim, mirëpo i njëjti me datë 16.11.2020 ka bërë kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës për rikthim/transferim në Qendrën e Paraburgimit të Lipjan. Ndërsa me datë 23.11.2020 Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes shkresës me numër protokollit 1001 të datës 23.11.2020 ka refuzuar kërkesën në fjalë të ankuesit.

Pas përgjigjes së datës 23.11.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ankuesi parashtron ankesë me numër protokollit 3037/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar që në mënyrë të detyrueshme është transferuar me datë 26.12.2019 në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, dhe se i njëjti kërkon që të rikthehet në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan.

Bazuar në nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020, Kolegji ka konstatuar me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe ligjeve të veçanta.

Bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Kolegji sjell në vëmendje faktin se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. Ndërsa sipas dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht neni 125 paragrafi 1 i këtij ligji përcakton se: *Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")* me tej neni 127 paragrafi 1 dhe 3 i të njëjtit ligj parasheh se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ;.. 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj",* dhe si rrjedhojë Kolegji duke marrë parasysh konfirmim e organit të punësimit së ankuesi Përgjigjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës të datës 23.11.2020, e ka pranuar fizikisht me datë 24.11.2020, si dhe nisur nga fakti së përgjigja në fjalë nuk përmban këshillë juridike lidhur me të drejtën e ankesës, Kolegji vlerëson se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill më datë 14.06.2021 është ushtruar jashtë afatit ligjor sipas nenit 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ashtu siç u konstatua me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.189/2022

Flakron GASHI



Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHC-s

